



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:265765
Datë: 22.11.2024
Numri i dokumentit: 06494723

AA.nr.940/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Hajriz Hoti kryetar i kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Arsim Hamzaj anëtarë, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit, G.M nga Prishtina, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Eris Hana, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës, Komuna e Prishtinës, për shkak të anulimit të vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.3950/2024, të datës;30.09.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë;21.11.2024, merr këtë,

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, G.M nga Prishtina, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3950/2024, i datës;30.09.2024, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3950/2024, të datës;30.09.2024, është vendosur, “*HEDHET poshtë si e parakohshme, padia e paditësit G.M, me nën shenjën A.nr.3950/2024, e dt.27.09.2019.*”

Kundër këtij aktvendimi paditësi ka ushtruar ankese, përmes të autorizuarit të tij, Eris Hana, avokat nga Prishtina, me të cilin konteston ligjshmërinë e të njëjtit, duke mos përmendur asnjë nga bazat ankimore nga neni 181 të LPK-së, me propozim që të aprovohet ankesa e paditësit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.3950/2024, të anulohet.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të aktvendimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se, ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë;27.09.2024, ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, kundër të paditurës, Komuna e Prishtinës, për shkak të anulimit të

vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nga arsyet e dhëna në padi dhe propozim.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit, jashtë seancë e hedhë poshtë padinë e paditësit si të parakohshme me arsyetim se “*Paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me dt.27.09.2024, përmes së cilës ka propozuar anulimin e vendimit të të paditurës me nr.09354/02-138546/23/23, të datës 20.12.2023, si dhe njëherit ka propozuar shtyrjen e ekzekutimit të tij. Gjykata ka bërë shqyrtimin paraprak të padisë me qëllim të vendosjes lidhur me propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të kontestuar dhe me këtë rast ka vërejtura se vendimi i kontestuar paraqet vendimin e shkallës së parë, e kundër të cilit pala paditësi ka pretenduar dhe ka paraqitur si provë dëshminë e dorëzimit të ankesës tek e paditura me datë 09.09.2024. Duke pasur parasysh se ankesë është dorëzuar tek e paditura me datë 09.09.2024, ndërsa padia është dorëzuar në gjykata me datë 27.09.2024, gjykata vlerëson se padia është parashtruar para kohe marr parasysh dispozitat e nenit 98 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, në të cilën dispozitë është përcaktuar: Afati për përfundimin e procedurës administrative 1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj. 3. Nëse me ligj parashihet detyrimi i palës për të parashtruar një dokument apo për të kryer një veprim procedural, si pjesë apo së bashku me parashtrimin e kërkesës për fillimin e procedurës, afati i përcaktuar në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni, do të fillojë të llogaritet nga parashtrimi i dokumentit apo kryerja e veprimit procedural përkatës. Prandaj marrë parasysh afatet ligjore si të përcaktuara me LPPA, gjykata gjen se në rastin në fjalë padia është parashtruar para kohë dhe nuk mund të iniciohet padia mbi bazën e heshtjes administrative, sic është e lejuar dhe pasi të jenë përmbushur kushtet e përcaktuara me dispozitat e nenit 14 dhe 29 të Ligjit për Konfliktet Administrative.”*

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Kolegji i apelit vlerëson si të drejtë këtë qëndrim juridik të dhënë në aktvendimin e ankimuar, pasi që paditësi nuk ka provuar para gjykatës, se i ka shterur mjetet e brendshme të ankimimit pranë të paditurës. Prandaj, kolegji i apelit verën se nga shkresat e lëndës, paditësi ka ushtruar ankesë te i padituri me datë:09.09.2024, kurse padinë në gjykatë e ka ushtruar më datë:27.09.2024, pa i shterur mjetet e brendshme të ankimimit, përkatësisht, pa vendosur e paraprakisht e paditura lidhur me ankesën e paditësit, detyrim ky ligjor, i cili është përcaktuar me nenin 124 paragrafi 5 të Ligjit për procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se “*6. Shterimi i mjetit juridik administrativ të rregullt, përkatës, është kusht paraprak për ngritjen e padisë në gjykatën kompetente për çështjet administrative. Përgjithësisht, mund të ngrihet drejtpërdrejt padi në gjykatë, pa qenë të nevojshme shterimi i mjeteve juridike administrative, në këto raste: 6.1. nuk ekziston organi epror; 6.2. palës së tretë i janë cenuar të drejtat apo interesat juridike nga akti administrativ që zgjidh ankesën, apo 6.3 parashikohet shprehimisht me ligj.”*

Në këtë kuptim kolegji i apelit vlerëson se paditësi nuk i ka plotësuar prezumimet procedurale për inicimin e çështjes në Gjykatë, sipas nenit 124 dhe të LPPA-së, lidhur me nenin 29 të LKA-së, për inicimin e konfliktit administrativ në gjykatë pa u shterur mjetet e brendshme të ankimit në procedurë administrative pa e pritur shqyrtimin e ankesën nga organi i paditur .

Prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit aktvendimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kolegji i apelit, ashtu që ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 dhe 209 pika b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.940/2024, datë;21.10.2024

Kryetari i kolegjit
Hajriz Hoti